VENDIM
Nr.6, datë 17.2.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar i " "
Xhezair Zaganjori	Anëtar i " "
Vitore Tusha	Anëtare e " "
Sokol Berberi	Anëtar i " "
Admir Thanza	Anëtar i " "
Altina Xhoxhaj	Anëtare e " "

me sekretare Brunilda Bara, në datat 19.5.2011 dhe 23.6.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 14/3 Akti, që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

Ministria e Financave, përfaqësuar nga Violanda Theodhori, me autorizim.

OBJEKTI: Zgjidhja e konfliktit ligjor ndërmjet vendimit unifikues nr.12, datë 14.9.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe akteve të tjera ligjore në fushën e sigurimeve.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, shkronja "d", dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 68 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Altina Xhoxhaj, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave, që kërkuan pranimin e kërkesës dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjykata referuese) është paraqitur për shqyrtim një çështje civile me objekt detyrimin e shoqërisë "Interalbanian" sh.a. të paguajë në favor të palës paditëse F.R. etj, dëmin real pasuror dhe jopasuror të shkaktuar si pasojë e aksidentit automobilistik me pasojë vdekjen e shtetasit A.R. Gjatë shqyrtimit të çështjes, gjykata referuese ka konstatuar se për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, ajo duhet t'i referohet dy rregullimeve ligjore që kanë trajtuar në mënyra të ndryshme të njëjtat çështje, nga njëra anë vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë, i cili është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga gjykatat më të ulëta dhe, si i tillë, merr fuqinë e ligjit, dhe nga ana tjetër aktet ligjore në fuqi në fushën e sigurimeve. Për këto arsye, me vendimin e datës 29.9.2010, gjykata referuese ka vendosur pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), duke parashtruar në thelb se:

- Duke pasur parasysh nenin 116 të Kushtetutës (që rendit aktet normative që kanë fuqi në Republikën e Shqipërisë) dhe nenin 141/2 të Kushtetutës (që përcakton funksionin unifikues të Gjykatës së Lartë), është krijuar një konflikt ligjor, i cili duhet të zgjidhet nga Gjykata.

- Një situatë e tillë e konfliktit/përplasjes midis këtyre akteve ligjore në fuqi çon në cenimin e parimit të sigurisë juridike.

- Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë, në raport me aktet ligjore që kanë rregulluar këtë fushë, ka mangësi për sa i përket dallimit të përgjegjësisë jashtëkontraktore që buron nga shkaktimi i dëmit, përgjegjësisë së shoqërive të sigurimit për dëmet e shkaktuara si rezultat i një aksidenti automobilistik, si dhe të dëmtuarve që legjitimohen të kërkojnë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga një aksident automobilistik.

Këto mangësi shkaktojnë një situatë jokushtetutshmërie, që ka të bëjë me shkeljen e parimit të sigurisë juridike dhe atij të barazisë para ligjit, të sanksionuar nga nenet 4 dhe 18 të Kushtetutës.

- Vendimi unifikues e ka zgjeruar numrin e përfituesve që legjitimohen të kërkojnë dëmin pasuror dhe jopasuror nga shoqëritë e sigurimit duke prishur balancën e skemës së sigurimit. Kjo situatë, në aspektin kushtetues, përbën një diskriminim të këtyre subjekteve në raport me subjektet e tjera të kësaj skeme, në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës.

2. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, parashtroi në mënyrë të përmbledhur se:

2.1 Për legjitimimin e kërkuesit:

- Në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës, gjyqtari vë në lëvizje procedurën e kontrollit incidental vetëm për norma të llojit "ligj" të cilave ai i nënshtrohet, që në aspektin formal nënkupton aktin normativ të miratuar nga Kuvendi. Kjo do të thotë se gjyqtari nuk mund të iniciojë kontroll kushtetues të një norme që ka renditje më të ulët se ligji, siç është rasti për gjykim ku kërkuesi ka paraqitur për kontroll një udhëzim të Ministrit të Financave. Në lidhje me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, lihet në vlerësim të Gjykatës analiza për llojin dhe renditjen hierarkike të tij, çka i shërben interpretimit të nenit 145 të Kushtetutës për të nxjerrë konkluzione, për të ardhmen, nëse legjitimohet një gjyqtar i zakonshëm të kundërshtojë një vendim unifikues në Gjykatë.

- Në kuptim të nenit 131 të Kushtetutës, Gjykata nuk ka juridiksion për të shqyrtuar përplasjet, devijimet dhe masën e harmonizimit midis dy akteve normative me njëra-tjetrën. Zgjidhja e përplasjeve midis vendimit unifikues dhe udhëzimit të Ministrit të Financave me Kodin Civil nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës.

- Udhëzimi i Ministrit të Financave është shfuqizuar tashmë dhe, si i tillë, nuk mund të japë shkas për nxjerrjen e një vendimi nga Gjykata mbi vlerën e tij.

2.2 Për themelin e kërkesës:

- Gjykata referuese ka dashur të prezantojë një problematikë që përfaqësohet përmes kolizionit të dy akteve të detyrueshme për zbatim nga sistemi gjyqësor, vendimet e Gjykatës së Lartë për njësimin e praktikës gjyqësore nga njëra anë dhe ligjet nga ana tjetër. Edhe pse çështja e kolizionit të ligjeve nuk hyn në juridiksionin kushtetues, praktikisht mund të ndodhë që për çështje të ngjashme të jepen zgjidhje cilësisht të ndryshme nga gjykatat dhe ky trajtim i diferencuar do të prekte standardet kushtetuese të barazisë para ligjit (neni 18 i Kushtetutës) dhe barazisë brenda procesit të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës).

- Në rastin në gjykim, Gjykata duhet të përcaktojë dimensionet e detyrueshmërisë së zbatimit të një vendimi unifikues të Gjykatës së Lartë prej gjykatave të niveleve më të ulëta. Çështja bëhet delikate në rastet kur i njëjti argument i detajuar fillimisht nëpërmjet një vendimi unifikues, gjen më vonë një trajtim nga një ligj specifik i miratuar nga Kuvendi. Në këtë rast duhet të sqarohet prevalenca e zbatimit mes këtyre dy akteve, veçanërisht kur mes tyre ka dhe ndryshime cilësore në trajtesën që i bëjnë argumentit përkatës.

3. ***Subjekti i interesuar, Ministria e Financave****, e përfaqësuar në gjykim nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, parashtroi në mënyrë të përmbledhur se*:

- Vendimi unifikues tejkalon kompetencat e pushtetit gjyqësor. Duke vendosur kufijtë e dëmshpërblimit Gjykata e Lartë ka marrë kompetenca që i takojnë organit ligjvënës, në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve, të sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës.

- Vendimi unifikues, në krahasim me përmbajtjen e ligjit ligjit nr.10076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", zgjeron rrethin e personave përfitues nga shoqëritë e sigurimit në rastin e një aksidenti automobilistik. Gjykata e Lartë, në këtë mënyrë, ka krijuar një normë të re, në kundërshtim me Kodin Civil, dhe që cenon parimin e sigurisë juridike.

- Vendimi unifikues njeh të drejtën e dëmshpërblimit për çdo lloj dëmi jopasuror jashtëkontraktor, pa asnjë lloj kufizimi. Një interpretim i tillë i Kodit Civil nuk mund të shtrihet edhe për shpërblimin e dëmit nga ana e shoqërive të sigurimit, sepse këto të fundit nuk kanë detyrimin ti paguajnë të gjithë të dëmtuarve dhe as të gjithë vlerën e dëmit. Në rastin e kontratës së sigurimit është ligji ai që ka përcaktuar primin (shpërblimin) që derdh çdo i siguruar dhe, si rrjedhojë, në raport me këtë përcaktohen edhe kufijtë e shumës që i paguan shoqëria e sigurimit personave të dëmtuar.

- Vendimi unifikues cenon sigurinë juridike edhe në një aspekt tjetër. Ai është kontradiktor për sa i përket përcaktimit të dëmshpërblimit për dëmin moral, ku fillimisht shprehet për caktimin e tij bazuar në bindjen e brendshme të gjykatës dhe më pas shprehet se ai duhet të përcaktohet bazuar në tabelat ligjore të dëmshpërblimeve. Kjo ka sjellë pështjellim e paqartësi në praktikë, sepse gjykatat i referohen herë tabelave ligjore e herë praktikës dhe bindjes së tyre të brendshme.

II

4. Gjykata Kushtetuese vëren se kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës, sipas të cilit, kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën nuk i zbatojnë ato, por pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen kësaj Gjykate, për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e tij.

5. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar nga neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i cili përcakton disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: së pari, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); së dyti, duhet të parashtrojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës (shih vendimet nr. 13, datë 4.5.2009 dhe nr. 2, datë 3.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese). Para marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Pra, duhet të çmojë se ligji që vlerëson si jokushtetues do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete. Në të kundërt, nëse gjykata referuese çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e saj për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas saj vlerësohet si jokushtetues, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes (*shih vendimet nr.5, datë 6.3.2009; nr.13, datë 04.5.2009 dhe nr.30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Gjykata vëren se objekti dhe shkaqet e kërkesës me të cilën ngrihet çështja e kushtetutshmërisë përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues. Në lidhje me objektin e kërkesës konstatohet se gjykata referuese ka kërkuar zgjidhjen e konfliktit ligjor midis vendimit unifikues nr. 12, datë 14.9.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe akteve të tjera ligjore në fuqi në fushën e sigurimeve, kurse për sa i përket shkaqeve të kërkesës ajo shprehet se ky konflikt cenon parimin e sigurisë juridike dhe atë të barazisë para ligjit. Pavarësisht sa më sipër Gjykata vëren se, në thelb të kërkesës, gjykata referuese ngre pretendime në lidhje me pajtueshmërinë me këto parime kushtetuese të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë.

7. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Ky funksion ushtrohet nga Gjykata e Lartë duke tërhequr për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara. Sa më sipër vjen si pasojë e pozicionit të saj si organi më i lartë i sistemit gjyqësor dhe lidhet me funksionin e përgjithshëm të saj për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit të cilave gjyqtarët duhet t'u përmbahen. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnë vetëm për rastin konkret të zgjidhur prej saj, por për të gjitha rastet e ngjashme për gjykatat e tjera, ose vetë kolegjet e thjeshta të asaj gjykate. Barazia në të drejta, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme nga gjykatat e zakonshme.

8. Veprimtaria gjyqësore konsiston në zbatimin e dispozitës ligjore (e hartuar përgjithësisht në terma të përgjithshëm dhe abstraktë) në një çështje specifike konkrete. Megjithatë, jo gjithmonë është e mundur për gjyqtarin të identifikojë normën (rregullin juridik) e zbatueshme në rastin në shqyrtim dhe një kërkim i tillë kryhet prej tij duke përdorur një seri kriteresh interpretativë. Interpretimi i ligjit ka si qëllim, së pari, ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore, por kur ajo kryhet me qëllim zëvendësimin e asaj që shfaqet si boshllëk i rendit juridik (mungesa e një dispozite të shprehur nga e cila të nxirret norma që duhet zbatuar në rastin konkret) ajo kthehet në një veprimtari që i ngjan asaj të krijimit të normave të reja juridike.

9. Gjykata vlerëson t'i referohet konceptit të së "drejtës së gjallë", e kuptuar përgjithësisht në sensin e ekzistencës së një "jurisprudence konstante", "të konsoliduar" mbi një dispozitë të caktuar ligjore (duke pasur

pra parasysh mënyrën se si ajo “jeton” në realitetin konkret). Përdorimi i formulës së “të drejtës së gjallë” e ndihmon Gjykatën të përcaktojë raportet me gjyqtarët e zakonshëm në terrenin e interpretimit të së drejtës (e njohur si detyrë që u takon posaçërisht këtyre të fundit) duke marrë në lidhje me këtë një qëndrim vetëkufizues (*self restraint*) në kuptimin që, nëse një e drejtë e tillë e gjallë ekziston, Gjykata e mban parasysh dhe (me disa përjashtime) nuk ndalet të bëjë një interpretim të ndryshëm, edhe atje ku i duket asaj më bindëse. Kompetenca e Gjykatës ndalet përpara interpretimit konstant jurisprudencial pasi, edhe në autonominë e saj të plotë të gjykimit Gjykata nuk mund të mos ketë parasysh një interpretim të tillë që i njeh normës legjislative vlerën e saj efektive në jetën juridike, duke qenë se normat janë jo ato që propozohen në mënyrë abstrakte por ato që zbatohen në punën e përditshme të gjyqtarit, që synon t’i bëjë konkrete dhe efikase (*shih vendimin nr.350, datë 13-21 nëntor 1997, të Gjykatës Kushtetuese Italiane*).

10. Qëllimi i Gjykatës nuk është të vërë në diskutim vlerën që kanë vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë në rendin juridik dhe as detyrimin ligjor që kanë gjykatat më të ulëta që të marrin parasysh dhe zbatojnë në çështje analoge zgjidhjet e dhëna në këto vendime. Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim mënyra si e ka paraqitur gjykata referuese këtë çështje del jashtë kuadrit të parimit të sigurisë juridike dhe atij të barazisë përpara ligjit. Gjykata thekson se çështja e shtruar para saj, në thelb, ka të bëjë me zbatimin e parimit të veprimit të ligjit të ri, të posaçëm, në kohë.

11. Gjykata vëren se kuadri ligjor në Shqipëri për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit është rregulluar fillimisht me dekretin nr. 295, datë 15.9.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”, i miratuar me ligjin nr. 7641, datë 1.12.1992 “Për miratimin me disa ndryshime të dekretit nr. 295, datë 15.9.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”.

12. Gjykata e Lartë, nisur nga qëndrimet e ndryshme të gjykatave për sa i përket zbatimit të ligjit lidhur me rrethin e personave të dëmtuar, të drejtën e përfitimit të dëmshpërblimit për dëmet jashtëkontraktore dhe mënyrën e llogaritjes së tij, veçanërisht atij jopasuror, vlerësoi se kishte vend për të mbajtur një qëndrim të unifikuar në lidhje me këto çështje. Me vendimin nr. 12, datë 14.09.2007 Gjykata e Lartë unifikoi praktikën gjyqësore në lidhje me zbatimin e neneve 608, 609, 625, 643/a e vijues të Kodit Civil, duke u shprehur, në thelb, për subjektet që kanë të drejtën subjektive (legjitimimin aktiv) për të kërkuar dëmshpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të pësuar, figurën e dëmit biologjik apo dëmit mbi shëndetin (si figurë e posaçme e dëmit jopasuror), figurën e dëmit moral dhe atij ekzistencial, metodologjinë e përllogaritjes së masës së dëmshpërblimit etj. Në lidhje me masën e dëmshpërblimit vendimi unifikues shprehet se gjykatat duhet të mbështeten në vlerat përkatëse të përcaktuara nga aktet ligjore në fuqi dhe vetëm në mungesë të këtyre kritereve tabelare ato vendosin sipas bindjes së tyre të brendshme, duke lënë të lirë mundësinë e përcaktimit të masës së dëmshpërblimit rast pas rasti.

13. Disa muaj pas daljes së vendimit unifikues u hartua akti normativ, udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24, datë 15.11.2007 “Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, kurse në vitin 2009 hyri në fuqi ligji nr.10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i cili rregulloi tërësisht fushën e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit. Ky ligj shfuqizoi ligjin nr.7641, datë 1.12.1992 dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij të fundit. Në nenin 26 të ligjit është parashikuar edhe kufiri i mbulimit të dëmit nga shoqëritë e sigurimit.

14. Gjykata ka vlerësuar se Kuvendi, si organ ligjvënës, ka të drejtë të zbatojë apo konkretizojë politika të caktuara për zhvillimin e vendit në tërësi, apo t’u përgjigjet prioriteteve apo problemeve të ndryshme të vendit (*shih vendimin nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” ka pasur si synim rregullimin e plotë të fushës së sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, duke parashikuar detyrimet e siguruesit dhe të të siguruarit, kushtet dhe tarifat e sigurimit të detyrueshëm, të drejtën e palës së dëmtuar të paraqesë kërkesë për dëmshpërblim, procedurën dhe afatet për rregullimin e shpërblimit të dëmeve, përgjegjësinë e shoqërisë së sigurimit dhe shumën e siguruar (kufiri i mbulimit) sipas figurave të dëmit etj. Ai përcakton tashmë edhe kriteret tabelare ligjore ku duhet të mbështeten gjykatat për përcaktimin e vlerës së

dëmshpërblimit, të cilat mungonin në momentin e daljes së vendimit unifikues. Ligji i ri, duke bërë një rregullim specifik të formulës së llogaritjes, ka vendosur rregulla të përgjithshme për çdo subjekt sigurimi dhe standarde të njëjta në trajtimin dhe vlerësimin e pagesave të dëmeve në territorin e Republikës së Shqipërisë. Me këtë ligj të posaçëm ligjvënësi plotësoi boshllëqet ligjore që ekzistonin në këtë fushë dhe që nxitën dhe sollën nevojën për interpretimin e disa dispozitave të përgjithshme të Kodit Civil nga ana e Gjykatës së Lartë.

15. Gjykata vëren se parimi i përgjithshëm është se ligjet i shtrijnë efektet për marrëdhëniet juridike që lindin pas hyrjes së tyre në fuqi. Teoria e së drejtës pranon se fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim, për shembull, në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm dhe në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme (*shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*. Kuvendi nuk ndalohet të miratojë ligje retroaktive ose të legalizojë me efekte retroaktive praktika ose marrëdhënie ekzistuese, të cilat njihen në doktrinën kushtetuese si ligje legalizuese, por kjo ndërhyrje duhet të justifikohet nga interesi publik dhe kusht për miratimin e këtyre ligjeve, që legalizojnë praktika ekzistuese, është që ato të mos shkelin autoritetin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave (shih vendimin nr.31, datë 18.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

16. Gjykata thekson se ligji i ri nuk mund të ndërhyjë në ato marrëdhënie juridike të cilat janë zgjidhur me vendim të formës së prerë, pra midis ligjit të ri dhe çështjeve që përbëjnë *res judicata* nuk mund të ketë lidhje juridike. Në rastin në shqyrtim, në këndvështrimin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, nuk konstatohet që qëllimi i ligjvënësit të ketë qenë miratimi i një ligji specifik *ad hoc* me qëllim që të influencojë në përfundimin e një çështjeje që është duke u shqyrtuar para gjykatës, apo rregullimi me efekte prapavepruese i marrëdhënieve që kanë lindur para hyrjes së këtij ligji në fuqi.

17. Në bazë të nenit 145 të Kushtetutës, gjyqtarët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës. Bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, marrëdhëniet midis normave juridike bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlerëshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përftuar kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimin nr. 3, datë 20.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimin nr. 2, datë 3.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se është detyrimi i gjykatës referuese dhe jo i kësaj Gjykate të verifikojë dhe përcaktojë, me qëllim identifikimin e ligjit të zbatueshëm në çështjen konkrete, momentin e lindjes së marrëdhënies objekt gjykimi në raport me momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit". Kjo bazuar edhe në parimet që udhëheqin sistemin tonë juridik, i cili bën pjesë në familjen e *Civil Law*. Ligji i mëvonshëm nuk lidhet me përcaktimet që ka bërë më parë praktika gjyqësore përderisa, siç u përmend më sipër, në bazë të nenit 145 të Kushtetutës gjyqtarët i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës.

19. Si përfundim, Gjykata rithekson se në thelb kjo çështje lidhet me fuqinë e vendimit unifikues përballë efekteve në kohë të ligjit të posaçëm në fushën e sigurimeve, megjithatë, duke pasur parasysh problematikën e ngritur në kërkesë, të konfirmuar edhe nga parashtrimet e subjekteve të interesuara në seancë gjyqësore, Gjykata vlerësoi se duhej të ndalej në parashtrimin e disa parimeve të përgjithshme, si më sipër, me qëllim orientimin e gjykatave në zgjidhjen e kësaj problematike. Gjykata e bën këtë sa herë lind nevoja për të rikonfirmuar rëndësinë e respektimit të parimeve të tilla kushtetuese si siguria juridike, barazia para ligjit, apo hierarkia e burimeve të së drejtës, si në rastin në fjalë. Gjykata konfirmon qëndrimin e saj se një çështje nuk hyn në sferën e kompetencës së Gjykatës nëse paraqet probleme të veprimit të ligjit në kohë (siç është rasti në shqyrtim) apo kërkon vlerësime lidhur me vendosjen respektive hierarkike të normave në konflikt, të cilat si të tilla hyjnë në sferën e kompetencës së gjykatës referuese. Për sa më sipër kërkesa është e pabazuar dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja "a", 134, pika

1, shkronja “d” dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69, 70, 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,[1]

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar) Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi.

MENDIM PARALEL

Në çështjen me kërkues Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me objekt “Zgjidhja e konfliktit ligjor ndërmjet vendimit unifikues nr. 12, datë 14.9.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe akteve të tjera ligjore në fushën e sigurimeve”, pajtohem me vendimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, por kam mendim të ndryshëm për sa i takon arsyeve për këtë qëndrim, ndaj e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim paralel.

Në qëndrimin e saj për këtë çështje, shumica, fillimisht, pranon se në thelb të kërkesës, gjykata referuese ngre pretendime në lidhje me pajtueshmërinë me disa parime kushtetuese të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë (paragrafi 6 i vendimit) por, me arsyetimet e shprehura në vijim, pa i dhënë përgjigje këtyre pretendimeve, shprehet se “çështja e shtruar para saj, në thelb, ka të bëjë me zbatimin e parimit të veprimit të ligjit të ri, të posaçëm, në kohë”. Në përfundim, shumica arrin në konkluzionin se çështja nuk hyn në sferën e kompetencës së Gjykatës Kushtetuese, për arsye se problemet e ligjit në kohë apo të hierarkisë së normave në konflikt, hyjnë në sferën e kompetencës së gjykatës referuese. Ndryshe nga ky përfundim, çmoj se shumica, në arsyetimet e shprehura në vendim, ka dalë jashtë objektit të gjykimit kushtetues, duke bërë vlerësime dhe analizuar aktet ligjore të çështjes konkrete (shih parag. 14, 18), të cilat i përkasin juridiksionit të zakonshëm gjyqësor. Mendoj se, fillimisht, shumica duhet t’i jepte përgjigje pyetjes nëse legjitimohet apo jo gjyqtari i juridiksionit të zakonshëm të kërkojë kontrollin kushtetues të një vendimi unifikues të Gjykatës së Lartë, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës. Për më tepër, ky pretendim është ngritur dhe nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, dhe për rrjedhojë duhej që të kishte marrë përgjigje në vendim. Në vijim do t’i përgjigjem këtij pretendimi duke argumentuar se gjyqtari i juridiksionit të zakonshëm nuk mund të kërkojë kontrollin kushtetues të një vendimi unifikues të Gjykatës së Lartë, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës, dhe, për rrjedhojë, kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duhet të ishte rrëzuar për këtë shkak.

Kushtetuta i ka njohur Gjykatës së Lartë të drejtën të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore (neni 141/2). Kjo realizohet nga Gjykata e Lartë duke tërhequr për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnë vetëm për rastin konkret të zgjidhur prej saj, pasi gjyqtarët/gjykatat e tjera që vendosin për raste identike/të ngjashme ose vetë Kolegjet e kësaj gjykate nuk mund të vijnë në përfundime të ndryshme nga ato në të cilat ka arritur Gjykata e Lartë. Detyrueshmëria për zbatimin e këtyre vendimeve parashikohet edhe në nenin 32/f të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit “moszbatimi i vendimit unifikues, (....) të Gjykatës së Lartë, (....) përbën shkelje që diskrediton rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit”. Po kështu edhe neni 438 i Kodit të Procedurës Penale sanksionon se vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme.

Procesi i njësimit të praktikës gjyqësore, nga njëra anë, dhe detyrimi i gjykatave të zakonshme për të zbatuar vendimet unifikuese, nga ana tjetër, i shërbejnë vlerave të uniformitetit, qëndrueshmërisë dhe parashikueshmërisë në zbatimin e së drejtës. Në këtë mënyrë, parandalohet arbitrariteti në zbatimin e ligjit dhe garantohen parimet kushtetuese të sigurisë juridike dhe barazisë përpara ligjit. Edhe GJEDNJ-ja, në mbështetje të kësaj ideje, është shprehur se “...Gjykata mendon se është në interes të sigurisë juridike, të parashikueshmërisë dhe të barazisë para ligjit që ajo të mos shmanget pa motiv të vlefshëm nga precedentët. ” (shih çështjen Chapman kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 18.1.2001)

[1] Gjyqtari S. Berberi votoi pro rrëzimit të kërkesës, por me arsyetim paralel.

Siç është evidentuar edhe nga shumica, kërkesa në rrugë incidentale, nëpërmjet së cilës gjykatat e zakonshme kanë akses në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës dhe neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Sipas nenit 145/2 të Kushtetutës, "kur gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e materialeve të saj Gjykatës Kushtetuese, për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit". Në vendimin e saj gjykata apo gjyqtari duhet të përcaktojnë dispozitat e ligjit që ata çmojnë se janë të papajtueshme me normat ose parimet e Kushtetutës. Neni 68 i ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese përcakton disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata ose gjyqtari për të iniciuar kontrollin incidental. Së pari, gjykata, gjatë një procesi gjyqësor duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); së dyti, gjykata duhet të parashtrojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit (të një ose të disa dispozitave të tij) duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës.

Neni 131 i Kushtetutës parashikon se Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e ligjit dhe akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën. Sipas interpretimit literal që i bëhet kësaj dispozite, çështja e kushtetutshmërisë që i nënshtrohet gjykimit kushtetues gjatë kontrollit incidental ka si objekt një ligj ose një akt që ka forcën e ligjit, të cilin gjykata referuese e konsideron si të vesuar nga pikëpamja kushtetuese.

Në çështjen konkrete, gjykata referuese ka iniciuar kontrollin incidental, duke pretenduar se vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë cenon disa parime kushtetuese (sigurinë juridike; barazinë përpara ligjit) dhe si i tillë është i papajtueshëm me Kushtetutën.

Mbaj qëndrimin se objekt i gjykimit kushtetues, në rastet kur kemi të bëjmë me një kërkesë në rrugë incidentale, është norma, pra rregullimi juridik. Në mënyrë të përmbledhur, gjykata gjykon mbi normën dhe shprehet mbi dispozitën, që është parashikimi tekstual/gjuhësor i normës. Dispozita përbën mjetin e nevojshëm të aksesit të normës në gjykimin e gjykatës, gjykim i cili zhvillohet mbi normën, duke e krahasuar atë me përmbajtjen e parimeve dhe standardeve kushtetuese. Në rast se gjendet përballë një interpretimi të konsoliduar të dispozitës në fjalë, siç është rasti i interpretimit të dhënë me vendimin unifikues, gjykata nuk mundet ta ndryshojë atë duke bërë një interpretim të ndryshëm, që e konsideron të pajtueshëm me Kushtetutën, por ajo mund të gjykojë mbi normën në kuptimin që i është dhënë nga vendimi unifikues. Nëse gjykata vlerëson se kjo normë, sipas interpretimit të dhënë nga vendimi unifikues që konkretizon zbatimin e saj, është e papajtueshme me Kushtetutën, ajo mund të kërkojë jokushtetutshmërinë e normës, duke u nisur nga detyrimi për të mos zbatuar asnjë dispozitë ligjore që çmohet se vjen në kundërshtim me Kushtetutën.

Në përputhje me këtë linjë arsyetimi, është detyrë e gjyqtarit të zakonshëm të përcaktojë objektin dhe standardin kushtetues të cenuar në funksion të inicimit të gjykimit kushtetues. Nëse gjyqtari i zakonshëm vlerëson se mënyra si është interpretuar dhe si zbatohet një dispozitë e caktuar në sistemin ligjor, nëpërmjet një vendimi unifikues, shkakton probleme kushtetutshmërie, ai mund t'i drejtohet Gjykatës duke kundërshtuar dispozitën përkatëse, e cila paraqitet e vesuar nga pikëpamja kushtetuese, si pasojë e interpretimit të dhënë asaj nga Gjykata e Lartë.

Për sa më lart, mendoj se kërkuesi nuk legjitimohet, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës, për të kërkuar kontrollin kushtetues të një vendim unifikues të Gjykatës së Lartë, dhe, për rrjedhojë, kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duhet të ishte rrëzuar për këtë shkak.

Anëtar: Sokol Berberi.